

Si mund të mësoj se si po performon fëmija im në një program?

Shkolla e fëmijës suaj do të organizojë konferenca prind-mësues dhe takime vjetore për prindërit e ELL për t'ju njoftuar për performancën e fëmijës suaj në shkollë. Për më tepër, çdo pranverë fëmijës suaj do t'i jepet mundësia për një Test të Arritjeve në Gjuhën Angleze, si Gjuhë e Dytë e Shtetit të Nju Jorkut (New York State English as a Second Language Achievement Test). Ky test mat përparimin e fëmijës suaj në të mësuarit e anglishtes. Testi mundësohet për të gjithë Nxënësit/et që Mësojnë Anglishten të regjistruar në nivelin K-12 në shkollat e Shtetit të Nju Jorkut. Rezultatet lejojnë nxënësit, mësuesit dhe prindërit të kuptojnë pikat e forta dhe fushat ku nxënësi ka nevojë për përmirësim, si të folurit, leximi dhe shkrimi. Rezultatet e këtij testi përdoren gjithashtu, për të përcaktuar nëse fëmija juaj do të vazhdojë të identifikohet si Nxënës që Mëson Anglisht në vitin tjetër akademik.

Ndjekja e Përparimit të Fëmijës Tuaj

Gjeni informacion mbi përparimin akademik të fëmijës tuaj duke u regjistruar në Llogarinë e re të Shkollave të NYC në **MyStudent.nyc**. Nëse keni nevojë për ndihmë për llogarinë tuaj, kontaktoni shkollën e fëmijës, mbikëqyrësin tuaj ose telefononi **311**.



Si të përfshiheni

- Sigurohuni që fëmija juaj të shkojë në shkollë në kohë çdo ditë, gati për të mësuar.
- Sigurohuni që fëmija juaj të lexojë dhe të përfundojë detyrat e shtëpisë çdo ditë.
- Takohuni me këshilltarin shkollor të fëmijës tuaj për të diskutuar mundësitë për kolegji dhe karrierë. Nuk është kurrë herët për të planifikuar.
- Merrni pjesë në të gjitha konferencat prind-mësues dhe takimet vjetore për prindërit e ELL.
- Ndihmoni fëmijën tuaj të marrë kartën për bibliotekën publike dhe shkoni shpesh aty.
- Merrni pjesë në workshopet dhe konferencat për prindërit, të ideuara posaçërisht për t'ju ndihmuar të mbështesni fëmijën tuaj.
- Shërbeni si prind vullnetar në shkollën e fëmijës tuaj.
- Krijoni një mjedis mbështetës në shtëpi për mësimin dhe studimin.
- Merrni pjesë në aktivitete shkollore si ekskursione, mbledhje, Shoqata Prind-Mësues, Shoqata e Prindërve dhe në takime të Këshillit të Arsimit të Komunitetit.



Për informacion shtesë:

- Flisni me mësuesin, drejtorin, këshilltarin shkollor, koordinuesin e prindërve, këshilltarin e shkollës ose koordinuesin dygjuhësh të fëmijës tuaj.
- Telefononi **311** për të gjetur adresën e zyrës së distriktit tuaj lokal dhe e vizitoni atë.
- Dërgoni e-mail në Divizionin e Nxënësve Shumëgjuhësh (Division of Multilingual Learners) në adresën **multilinguallearners@schools.nyc.gov**.
- Vizitoni **faqen e internetit të Shkollave Publike të NYC**.



PËR PRINDËRIT E SHKOLLAVE TË MESME DHE TË MESME TË LARTA



NXËNËS QË MËSOJNË GJUHËN ANGLEZE



Shkollat Publike të Nju Jorkut (New York City Public Schools) (NYCPS) janë të përkushtuara për t'u ofruar Nxënësve/eve që Mësojnë Gjuhën Angleze një arsim të cilësisë së lartë, që vlerëson kulturën e tyre dhe i përgatit për shkollën e mesme, kolegjin dhe suksesin në karrierën e ardhshme.

Zyra për Nxënësit/et Shumëgjuhësh/e e Shkollave Publike të Nju Jorkut (New York City Public Schools) punon me familjet, komunitetet dhe partnerë të tjerë për të siguruar që nxënësit dhe nxënëset të kenë qasje të barabartë në programet që i ndihmojnë të mësojnë anglisht dhe të arrijnë sukses në të gjitha lëndët, përfshirë matematikën, shkencën dhe studimet sociale.

PYETJE TË SHPESHTA

Çfarë do të thotë të jesh Nxënës që Mëson Anglisht (English Language Learner)?

Një Nxënës/e që Mëson Gjuhën Angleze ose ELL, është ai/a jo nxënës/e, gjuha amtare e të cilit/cilës nuk është anglishtja dhe ka nevojë për mbështetje për ta mësuar atë.

Si përcakton shkolla nëse fëmija im është ELL?

Të gjithë prindërit dhe kujdestarët e nxënësve të sapo regjistruar duhet të plotësojnë një Anketë Identifikimi të Gjuhës së folur në Shtëpi, gjë që i mundëson stafit të shkollës të dijë se çfarë gjuhe përdor fëmija juaj në shtëpi. Nëse anketa tregon se fëmija juaj përdor një gjuhë tjetër përveç anglishtes, mund t'i jepet Testi i Identifikimit për Nxënësit/et që Mësojnë Gjuhën Angleze i Shtetit të Nju Jorkut. Ky test mat njohuritë e fëmijës tuaj në anglisht dhe përcakton nëse ka nevojë për programe dhe shërbime mbështetëse. Nëse testi tregon se fëmija ka nevojë për mbështetje në mësimin e anglishtes, ai/a jo identifikohet si një Nxënës/e që Mëson Gjuhën Angleze.

Çfarë lloj programesh dhe shërbimesh janë në dispozicion të fëmijës tim?

Departamenti i Edukimit i Nju Jorkut ofron tre programe për Nxënësit/et që Mësojnë Gjuhën Angleze: Gjuhë e Dyfishtë (Dual Language), Edukim Dygjuhësor Tranzicional (Transitional Bilingual Education) dhe Anglisht si Gjuhë e Re (English as a New Language).



Cilat janë ndryshimet midis këtyre programeve?

Në **Programet e Gjuhës së Dyfishtë** nxënësve/eve u mësohen në dy gjuhë: anglishtja dhe gjuha e tyre amtare, si për shembull spanjisht, kinezisht, frëngjisht, etj. Qëllimi i këtij programi është që nxënësit të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe flasin si në anglisht, ashtu edhe në gjuhën e tyre amtare. Në klasat e Gjuhës së Dyfishtë përdoren në nivel të njëjtë gjuha amtare dhe anglishtja.

Programet e Edukimit Dygjuhësor Tranziciona ofrojnë mësimdhënie në lexim, shkrim dhe lëndë të tjera si në anglisht, ashtu edhe në gjuhën amtare të fëmijës tuaj. Ndërsa përmirësohen aftësitë e nxënësit në anglisht, koha e kaluar duke mësuar në anglisht rritet dhe koha e kaluar duke mësuar në gjuhën amtare pakësohet. Pasi fëmija juaj të mos identifikohet më si Nxënës që Mëson Gjuhën Angleze, ai/a jo do të dalë nga programi.

Programet e Anglishtes si Gjuhë e Re të quajtura më parë Anglishtja si Gjuhë e Dytë, (ESL), ofrojnë mësim në gjuhën angleze me mbështetje të gjuhës amtare të nxënësve/eve, në mënyrë që të mësojnë të lexojnë, shkruajnë dhe flasin anglisht. Nxënësit/et në këtë program mund të vijnë nga origjina me shumë gjuhë të ndryshme dhe anglishtja mund të jetë gjuha e vetme e përbashkët mes tyre.



Çfarë përfitimesh kanë këto programe?

Përfitimet nga programet për Nxënësit që Mësojnë Gjuhën Angleze janë të shumta:

Nxënësit mund të përdorin gjuhën e tyre amtare për të mësuar anglisht.

Mësojnë të vlerësojnë kultura të ndryshme.

Njohuria e dy ose më shumë gjuhëve kanë vlera për punëdhënësit e ardhshëm dhe ata/ato nxënës/e që flasin këto gjuhë gjejnë më lehtë punë.

A mund të zgjedh në cilin program të regjistroj fëmijën tim?

Po. Si prind ose kujdestar i një Nxënësi që Mëson Gjuhën Angleze, keni të drejtën të zgjidhni programin që dëshironi për fëmijën tuaj. Pasi ta zgjidhni, ai/a jo duhet të nisë programin e zgjedhur brenda 10 ditëve nga regjistrimi.

Çfarë ndodh nëse shkolla nuk ofron programin që dëshiroj?

Nëse programi që keni zgjedhur nuk është i disponueshëm në shkollën aktuale të fëmijës tuaj, shkolla do t'ju ofrojë dy opsione:

Opsioni 1: Mund ta mbani fëmijën tuaj të regjistruar në shkollën aktuale, por në një program tjetër për Nxënësit që Mësojnë Gjuhën Angleze. Nëse zgjidhni këtë opcion, shkolla do ta regjistrojë menjëherë fëmijën tuaj në atë program.

Opsioni 2: Mund ta transferoni fëmijën tuaj në një shkollë që ofron programin që ju intereson. Shkolla juaj aktuale do të bashkëpunojë me Departamentin e Edukimit për transferimin e fëmijës. Ndërkohë, fëmija juaj do të vendoset përkohësisht në një program për Nxënësit që Mësojnë Gjuhën Angleze në shkollën aktuale derisa transferimi të përfundojë.